

EMPLOY -YOUR- SELF!

Nëntor 2019

Nr.1

Mundësitë e Punësimit për të Rinjtë në Ekonominë Sociale

Në këtë numër

Po bashkëndajmë me ju detajet nga Opening event, Fjalët e Koordinatorit të Projektit dhe Informacione rreth eventit të radhës të projektit

Employ Yourself kafilluar! >>>

Për disa vite, të gjitha organizatat e Caritas në rajon kanë zbatuar programe për grupet më vulnerabel të shoqërisë, ndër të cilat të rinjtë janë njohur si një ndër kategoritë më vulnerabel, veçanërisht në drejtim të punësimit. Prandaj jemi shumë të lumtur që Bashkimi Evropian në kuadër të programit Erasmus+ ka njohur përpjekjet e Caritas-it dhe vendosi të mbështesë përpjekjet që synojnë fuqizimin e mëtejshëm të të rinjve!

Me projektin e ri "Employ Yourself", organizatat e Caritas nga Evropa Jug-Lindore do të forcojnë sëbashku aftësitë e organizatave rinore në zhvillimin e prespektives së ekonomisë sociale duke siguruar njohuri, aftësi dhe shkëmbimin e informacionit mbi praktikatat e mira ekzistuese, si dhe rritjen e vetëdijes dhe njohurive të të rinjve për mundësitë e ofruara nga ekonomia sociale në Evropën Jug-Lindore.



Steering group



Opening Event

Opening Event e projektit "Employ Yourself" ishte aktiviteti i parë i këtij aksioni, i cili u mbajt me 20 nëntor, në Sarajevë (Bosnje dhe Hercegovinë). Projekti u prezantua publikisht tek aktorë të ndryshëm që mbështesin rininë, ekonominë sociale dhe mundësitë që ai ofron. Ishte një mundësi që palët e interesuara nga rajoni të njohin njëri-tjetrin, të ndajnë praktikatat e mira dhe vështirësitë e tyre. Në panelin e diskutimit të eventit, u diskutua se si mungesa e legjislacionit për sipërmarrjen sociale mund të pengojë zhvillimin në këtë rajon; si është e mundur që të angazhohen të rinjtë në punësim dhe të sigurohen trajnime shtesë për të korrigjuar mospërputhjet dhe për të rritur aftësitë që rinjtë kanë në tregun e punës

~ Të rinjtë në të gjithë rajonin janë në një pozitë falenderuese.

Qeveria ka një mungesë të përgjithshme të perspektivës, nuk kujdeset për shoqërinë rreth nevojave të tyre, gjë që i bën ata të pamotivuar për çdo ndryshim, qoftë në nivel personal ose në nivel shoqëror.


Me këtë projekt ne do të përpiqemi të kapërcejmë këtë situatë dhe t'u mundësojmë atyre që të forcojnë dhe rrisin vetëdijen për kapacitetet e tyre dhe pastaj sëbashku me moshatarët e tyre të jenë ndryshimi që është i nevojshëm nga kjo shoqëri.

Miroslav Valenta, Koordinator i Projektit



Aktiviteti I Radhës >>>>>

Vizitë Studimore në praktikatat më të mira të ekonomisë sociale për të rinjtë në Evropë



Vendi: Torino (Itali)

Data: 17-21 Shkurt, 2020

Vizita Studimore do t'u ofrojë subjekteve rinore lokale njohuri konceptuale dhe praktike në lidhje me perspektivat e ekonomisë sociale dhe vetpunësimin e të rinjve të ofruar në kontekstin e BE-së. Vizita Studimore do të paraqesë ekonominë sociale në Itali dhe informacionin dhe situatën përkatëse; pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të njihen me përvojat e ndryshme dhe të shohin praktikatat më të mira.



Materialet arsimore të përdorura gjatë kësaj vizite studimore do të përmbliken pas vizitës dhe do të ngarkohen si Burim Arsimor i Hapur në faqet e internetit të çdo partneri dhe shpërndahen midis partnerëve dhe subjekteve të tjera vendore.

Projekti „Employ Yourself“ është i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes programit të Erasmus+ dhe i udhëhequr nga Caritas Bosnje dhe Hercegovina, në bashkëpunim me Caritas-es kombëtare nga 7 shtete: Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Italia, Kosova, Mali i Zi, Serbia.



Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union